



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 21.11.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 2 (dy). 1 seancë dëgjimore + 1 seancë dhënie vendimi
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi I Vettingut të subjektit të rivlerësimit z. Enton Dhimitri.		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Enton Dhimitri.		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Gjyqtar, në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër. Kandidat për KED.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u zhvillua e plotë, në intervalin kohor 11:30-12:40. Trupa gjyqësore e KPK u tërhoq për të marrë vendimin, duke shtyrë seancën për të nesërmen (dt. 22 nëntor).		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Shpallja e vendimit është shtyrë për dt. 22 nëntor, ora 09:00.		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqësore (emrat)	Xhensila Pine - Kryetare e trupit gjyqësor; Pamela Qirko - Relatore e çështjes; Genta Tafa - anëtare e trupit gjyqësor; asistohen nga sekretarja gjyqësore- Anisa Duka. Të pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet, z. John Leonardo. I pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u realizua personalisht.		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri I anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 20-25 persona, pavarësisht masave të sigurisë, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye në formë të rregullt nga stafi menaxhues I KPK.		
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme, me përafërsisht 5 përfaqësues, me akses të plotë në hyrjen e godinës.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse jo, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Po	Trupa gjyqësore vendosi të përfundoj hetimin administrativ kryesisht dhe të paraqesë rezultat e tij për të tre kriteret e rivlerësimit: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike.	Subjekti I rivlerësimit e cilësoj metodologjinë e procedurës së ndjekur nga KPK, në tërësinë e saj të rregullt, por kundërshtoj disa nga përfundimet e hetimit administrativ, konkretisht sa i takon Kontrollit të figurës
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
	Referuar të dhënave në Raportin Vlerësues të ILDKPKI dorëzuar pranë Komisionit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit konstatohet se: Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.	Të dhëna nga raportet e ILDKPKI	Provat e administruara nga Komisioni lidhur me Vlerësimin e pasurisë: Dokumentacioni i administruar në dosjen ILDKPKI, provat e dorëzuara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve drejtuar nga Komisioni, të dhëna marrë nga institucionet shtetërore.

D1. Pasuria	<p>Komisioni kreu hetim të pavarur administrativ mbi verifikimin e vërtetësinë së deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konfirmon këto pasuri: 1- Automjet, Scoda, vlera 13,900 Eur. Burim krijimi: kursimet nga paga (5000 Eur) dhe kredi bankare (9000 Eur). Nga hetimi konfirmohet shitja e automjetit sipas deklaramit. 2- Apartament banimi, Gjirokastër, i regjistruar, vlera 4 milion lek, pjesë takuese 50%. Burim krijimi: kursimet nga pagat (1,094, 340 Lek) dhe kursimet e llogarisë bankare të bashkëshortes (20, 700 Eur). Nga ZRPP rezultojnë të pasqyruara rregullisht. Konstatohet se ka burime financiare të mjaftueshme e të ligjshme për pagesën e apartamentit. 3- Apartament banimi, Sarandë, i paregjistruar, çmimi 38, 500 Eur, përfutur me deklaratë noteriale, lidhur me personin e lidhur te subjektit të rivlerësimit, pjesa takuese e personit të lidhur 100%. Burim krijimi: kursimet nga pagat dhe aksionet e përfutuara. Nga hetimet e kryera konfirmohet ekzistenca e apartamentit dhe rezulton se kjo pasuri figuron e paregjistruar në ZRPP Sarandë. Ka burime te ligjshme e të mjaftueshme për pagesën e këtij apartamenti. 4- Sende të tjera të luajshme për mobilim vlera 1,9 milion lek dhe 360, 107 lek. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë bërë deklaram të saktë dhe kanë burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për pagimin e mobilimeve.</p>	Relatori	
	nuk ka	Mbrojtja	
	<p>Subjekti i rivlerësimit prapëson: 1- Në lidhje me pasurinë (automjet, Scoda), pasi u kërkuan nga Komisioni shpjegime për deklarimin e vlerës së automjetit dhe faktit që çmimi i rishitjes nga pala shitëse është vetëm 73 euro mbi çmimin e blerjes fillestare, subjekti sqaroi se bashkëshortja ka lidhje farefisnore me ortakun e shoqërisë shitëse të cilët mundësuan shitjen e automjetit me fitim minimal. 2- Lidhur me pasurinë (Apartament, Gjirokastër), subjektit iu kërkuan shpjegime për arsyen e çmimit tepër të ulët të apartamentit krahasuar me çmimet e tregut si dhe për arsyen e mos përfshirjes në kontratë të sipërfaqeve të përbashkëta. Lidhur me çmimin e ulët të apartamentit subjekti pretendoi se kjo lidhje me faktin që punimet nuk kishin përfunduar tërësisht, dhe pala shitëse ishte në vështirësi financiare dhe kishte nevoja emergjente për likuiditet. Në lidhje me mungesën e përfshirjes së sipërfaqeve të përbashkëta në kontratë, shpjegoi se në kontratë është deklaruar pasuria e pasqyruar në Vërtetimin e pronësisë ku nuk rezultoi sipërfaqet e përbashkëta. Ky fakt konfirmohet edhe nga ZRPP e cila deklaroi që ka mungesë baze ligjore për të detyruar regjistrimin e pasurive të përbashkëta (si pasuri në bashkëpronësi të detyrueshme).</p>	Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
	Përfaqësuesi I ONM		
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	<p>Të dhënat nga raportet sekret i DSIK, në përputhje me N.39 të ligjit 84/2016 dhe pikës DH të aneksit të Kushtetutës, konstatojnë vlerësimin: "I Përshtatshëm" për vazhdimin e zhvillimit të detyrës. Pas të dhënave të marra rishtazi nga denoncimet pranë Komisionit, grupi i punës pranë DSIK, ndryshon konstatimin fillestar në "papërshtatmërinë" e subjektit në vazhdimin e detyrës.</p>	Të dhëna nga raportet e DSIK	Raporti Vlerësues I Drejtorisë së Sigurisë dhe Informacionit të Klasifikuar, Denoncimet e shtetasve pranë KPK. Subjektit të rivlerësimit i kërkohen shpjegime dhe i kalon barra e provës për të vërtetuar dijeninë e plotë në lidhje me përfshirjen e anëtarëve të familjes me krimin e organizuar, si edhe në lidhje me kontaktet dhe afinitetin me kunatin e tij dhe arsyen e mos deklaramit të përfshirjes së kunatit të tij në aktivitete që lidhen me krimin e organizuar
	<p>Relatori i çështjes referon hetimin e pavarur të kryer nga Komisioni, konkretisht, marrjen e një denoncimi nga shtetasi P.M. në 2018, ku nga verifikimet e Komisionit dhe ONM, konstatohet se shtetasi me iniciale L.G (kunati i subjektit) është person i lidhur me krimin e organizuar (N.3 të ligjit 84/2016). Këto të dhëna i janë bërë të ditura DSIK, e cila rideklaron raport të dytë verifikues, ku deklaroi se shtetasi D.K. konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar, por nuk ekziston asnjë lidhje mes këtij shtetasi dhe subjektit të rivlerësimit. KPK përfundimisht konstaton se Deklarata per kontrollin e figurës nuk është plotësuar mjaftueshëm dhe me vërtetësi nga subjekti.</p>	Relatori	
		Mbrojtja	

	<p>Subjekti I rivlerësimit deklaroi se nuk ka pasur kontakte me kunatin e tij në tre vitet e fundit, mendoj të ketë pasur marrëdhënie afrimiteti me këtë person (Kunatit), si edhe nuk ka pasur asnjë informacion mbi rekordet kriminale të tij duke qenë se: së pari ai jetonte dhe punonte në shtetin Grek, ka pasur marrëdhënie të tensionuara me këtë subjekt për shkak të divorcimit të tij dhe lënies pa kujdes të fëmijëve të mitur, dhe angazhimeve të subjektit të rivlerësimit në punë dhe familje ku dy nga pjesëtarët e familjes rezultojnë me probleme shëndetësore, përbëjnë fakte që subjekti mos të ketë interes për marrjen e informacioneve të mëtejshme lidhur me kunatin e tij. Gjithashtu, nga verifikimi i Regjistrimit të gjendjes gjyqësore, si i vetmi dokumentim zyrtar i rekordeve kriminale, ky shtetas (kunati i subjektit të rivlerësimit) rezultoi i padënuar. Lidhur me këtë ka paraqitur në efektin e provës Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore të kunatit të tij, ku figuron i padënuar.</p>	<p>Subjekti I rivlerësimit</p>	
		<p>Ankesa nga publiku Përfaqësuesi I ONM</p>	
<p>D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës</p>	<p>Të dhënat marrë nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë: kanë treguar se subjekti I rivlerësimit ka cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë dhe është eficient në masë të pranueshme duke ruajtur të pastër figurën e gjyqtarit.</p> <p>Relatori I çështjes referon lidhur me denoncimet e marra nga shtetasit, se nuk ka prova për të provuar pretendimet e denoncuar, kjo edhe për faktin se këto pretendime janë të tilla që mund të kontrollohen e vlerësohen vetëm nga instancat gjyqësore, duke mos qenë objekt shqyrtimi i komisionit</p> <p>nuk ka</p> <p>Subjekti I rivlerësimit konfirmon marrjen dajeni mbi dosjen dhe dokumentat provues. Miraton deklaratimet e KPK mbi përfundimet e hetimit administrativ lidhur me këtë pikë</p> <p>nuk ka</p>	<p>Të dhëna nga Inspektoriati I KLD</p> <p>Relatori</p> <p>Mbrojtja</p> <p>Subjekti I rivlerësimit</p> <p>Ankesa nga publiku Përfaqësuesi I ONM</p>	<p>Provat e administruara në seancë dëgjimore: Raporti I vlerësimit të aftësive profesionale të Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; 8 denoncime të marra nga publiku të cilët mund hedhin dyshime mbi procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë procesit gjyqësor, vendimmarrjen e tij, dhe korrupsionin e mundshëm. Relatori nuk referoj akte të tjera provuese marrë për vlerësimin e aftësive profesionale</p>
<p>E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për të dëgjuar, etj.)</p>	<p>Aksesi I pjesëmarrjes është respektuar. Etika e sjelljes së trupit gjyqësor është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm, pavarësisht disa sjelljeve që tregojnë mungesë durimi dhe vëmendje nga Relatorja e trupit gjyqësor, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit merr fjalën për tu shprehur. Pas çeljes së seancës dëgjimore, referuar nenit 55 të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar", prezantohet trupa gjyqësore, i jepet mundësia subjektit të rivlerësimit të referoj publikisht gjeneralitetet dhe funksionin përkatës për identifikim dhe prezantohet nga kryesuesja e trupit gjyqësor një parashtrim i shkurtër i procedurës së seancës dëgjimore. Deklarohen nga relatori i çështjes dhe konfirmohen nga subjekti respektimi i të drejtave të tij procedurale si: është njoftuar për procedurën e fillimit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupës gjyqësore, për të cilët nuk ka pasur deklaratim për konflikt interesi. është njohur me dokumentet e dosjes dhe të drejtat e saj në përputhje me K.Pr. A. I janë dhënë 17 ditë kohë për tu njohur me dosjen, dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe iu bënë të ditura rezultatet e hetimit administrativ më 2 nëntor. Më 19 nëntor subjekti paraqiti qëndrimin e saj me shkrim. I rezervohet e drejta përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, dhe trupit gjyqësor të drejtojnë pyetje, dhe iu dha mundësia e fjalës në seancë dëgjimore subjektit të rivlerësimit. Kohëzgjatja e seancës dëgjimore është e arsyeshme (1 orë 10 minuta), duke marrë parasysh se kohën më të madhe e morën parashtrimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjyqësor tërhoqet për shpalljen e dispozitivit të vendimit, duke shtyrë seancën për të nesërmen. Gjithashtu, konfirmohet se trupa gjyqësore i rezervon më tepër kohë dhe prioritet parashtrimin në seancë të gjetjeve të hetimeve të pavarura administrative që ka kryer. Krahasuar me seancat e mëparshme ku evidentonte vetëm rezultatet e hetimit, tashmë parashtron në formë shteruese të gjitha gjetjet, aktet provuese, kalimin e barrës së provës dhe bazën ligjore ku është mbështetur për secilin nga kriteret e vlerësimit. Kjo është një risi pozitive pasi ndikon drejtpërdrejt në transparencën e procesit hetimor dhe vendimmarrës. Sa më sipër, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit z. Anton Dhimitri, plotëson kriteret që referon ligji nr. 84/2016, Kodi i Procedurës Administrative (Nenet 45-47) dhe Aneksi shtojcë i Kushtetutës, referuar të drejtave procedurale dhe respektimit të elementeve përbërës të procesit të rregullt ligjor, mbrojtjes efektive, aksesit në gjykim, kohëzgjatjes së arsyeshme të seancës.</p>		